



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.988/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevci kryesues, Zyhdi Haziri Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, Valdet Raka nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** pjesërisht i bazuar apeli Anr.988/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e e Kaçanikut, Valdet Raka nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 0701D/04R.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në Komunën e Kaçanikut, në vendvotimin 0701D/04R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimet si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**IV. Refuzohet** pjesërisht apeli Anr.988/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e e Kaçanikut, Valdet Raka nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 0720D/02R.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.988/2021, i Paraqitur nga kandidati për Kuvend Komunal Valdet Raka nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Kaçanik, me të cilën pretendon se në vendvotimet 0701D/04R, 0720D/02R, ka mos përputhje të rezultateve. Me apel ka bashkangjitur deklaratat e votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është pjesërisht i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Kaçanik, Valdet Raka, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartcekura, PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin si në pikën II të dispozitivit është i bazuar.

Paneli vlerëson se sa i përket pikës II të dispozitivit apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, ku shihet qarte se nga deklaratat e votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës, të cilët deklarojnë se në vendvotimin 0701D/04R, kanë votuar për kandidatin Valdet Raka, ndërsa votat që figurojnë në rezultatet përfundimtare të KQZ-së nuk përputhen me deklaratat e dhëna si dëshmi nga votuesit e që janë të bashkangjitura në apel. Në vendvotimin e lartcekur për kandidatin Valdet Raka, sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së, figuron vetëm një votë, ndërsa për të njëjtin vendvotim në apel janë të bashkangjitura katër deklaratat e votuesve që dëshmojnë se kanë votuar kandidatin Valdet Raka.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këto vendvotime e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe


kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Sa i përket pjesës refuzuese si në pikën IV të dispozitivit, Paneli erdhi në përfundim se vendvotimi për të cilin ka pretenduar apeluesi 0720D/02R se ka pasur parregullësi nuk është i plotë dhe i njëjti si i tillë ne tabelen e Rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja për Komunën e Kaçanikut nuk figuron fare, ngase nuk ekziston ky vendvotim në Komunën e Kaçanikut, për këto arsye u vendos si në pikën IV të dispozitivit.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartcekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 988/2021 më datën 07.11.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.